

## POLITIKA SERBE NDAJ SHQIPËTARVE NË FILLIM ZË SHEKULLIT XX - SIPAS DOKUMENTAVE SERBE 1912-1941

**Muzafer BISLIMI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup>Profesor ordinar në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodi"-Shkup - Zëvendës Drejtor në Arkivin Shtetëror të RMV

<sup>2</sup>muyzafer.bislimi@unite.edu.mk

Politika serbe ndaj shqiptareve duke filluar nga Naçërtanja e Garashaninit, e shekullit XIX dhe këto dokumenta që do paraqiten më poshtë, dëshmojnë shumë qartë se politika serbe ka patur një vazhdimësi kundër shqiptarëve edhe atë në disa drejtime.

Pjesa e parë, ka qenë hartimi i strategjive dhe elaboreve famëkeqe kundër shqiptarëve për zgjerim të teritoreve të shtetit të vogël serb por me apetite të mëdha dhe gjithë kjo, në pjesën më të madhe në dëm të trojeve etnike shqiptare.

Këtë më poshtë do ta ilustruajmë dhe faktografojmë me dokumente origjinale të tyre, të sajuara në kuzhinat e tyre antishqiptare. Do shohim si Serbia pregadiste terrenin për okupim të trojeve shqiptare, ku do analizojmë dy dokumente nga viti 1912, pastaj një Udhëzim-Direktivë prej 17 faqeve për strategjinë e veprimit të organeve të pushtetit serb ndaj shqiptarëve të vitit 1924 dhe në fund një dëshmi për shpërnguljen masive të shqiptarëve nën trysinë e pushtetit serb drejt Turqisë, në vitet 1927, 1928 dhe 1929.

Dokumenti i parë është i vitit 1912, i Ministrit të punëve të jashtme serb të asaj kohe, Jovan Jovanović-Pizhon, i datës 11 korrik 1912, ku në një dokument pasqyrohet tërë qëndrimi i politikës serbe kundrejt shqiptarëve. Dokumenti ka titull: "DIREKTIVA PËR VEPRIMET NDAJ SHQIPTARËVE" dhe i dërguar gjitha njësive konsulare serbe në Perëndorinë Osmane, kuptohet në trojet shqiptare.<sup>1</sup>

*"Qëndrimi ynë për sa i përket marrëdhënieve tona me shqiptarët, sipas kësaj është si vijon:*

*Duhet me të gjitha mjetet të shkaktujmë dhe ndihmojmë një përjarje sa më të madhe mes Turqve dhe Shqiptarëve, ndarja duhet të jetë aq e thellë sa që asnjëherë të mos mundet të evitohet. Shqiptarët, pra duhet të inkurajohen në luftën kundër Turqisë, edhe jo vetëm atë por në këtë edhe tu ndihmohet. Por nuk duhet harruar dhe ajo ndihmë të i fuqizojë tepër e të bëhen zot të situatës dhe faktorizohen. Sa është në interes të serbëve që pushteti turk ndaj shqiptarëve të zvoglohet dhe pamundsohet, aq është në interes tonin ndoshta edhe më shumë që shqiptarët mos e shkatërrojnë pushtetin turk në luftën mes tyre, posaçërisht nëse ajo luftë si ç'është rasti tash të ketë karakterin e revolucionit të përgjithshëm popullor. Ne duhet tu japim shqiptarëve ndihmën që ju duhet në luftën kundër ushtrisë turke (me këshilla, armë, municion, njerëz të trajnuar, para*

<sup>1</sup> Arkivi shtetëror i RMV, MF.477; Letër e ministrit të punëve të jashtme të Serbisë, Jovan Jovanović-Pizhon, deri te njësia konsulare e ministrisë së jashtme, Beograd, 11.07.1912.

etj)por njëkohësisht të jemi të vëmendshëm mos e humbim tërësisht besimin e turqve dhe mos u pengojmë shumë turqve kur ngrejnë ushtrinë për të shuar kryengritjen shqiptare. Në këtë mënyre Ne do të arrinim këtë:

- a) Shqiptarët dhe turqit në luftën mes tyre aq do të dobsoheshin sa që këta të fundit do të ishin të paaftë të luftonin kundër Serbisë ( edhe kundër aleatëve të saj, Bullgarisë, Greqisë dhe Malit të Zi, sepse mes tyre patjetër do arrihet një Aleancë Luftarake) në një luftë e cila patjetër se do vijë, ndërsa tek të parët të arrihet përshtypja se ata (shqiptarët, v.a.) nuk mund të bëjnë asgjë kundër turqve pa ndihmën tonë (të Serbisë, v.a.)
- b) Shqiptarët në Ne, do të shihnin mikun a vërtetë dhe mbrojtësinë e tyre dhe që një ditë do të hynin me ne në një unitet polkitik.
- c) Serbia në këtë mënyrë do të mbante forcën e saj të paprekur për përlëshjen përfundimtare që një ditë do të ketë me turqit.

*Këtë pikqëndrim duhet ta ndërmarrin edhe malazezët. Ne duhet tek shqiptarët të krijojmë miq, të definojmë marrëdhëniet e besimit të ndërsjelltë, aq sa në njëfarë mënyre edhe të krijojmë mosbesim tek pala turke. Ardhmëria jonë kombtare duhet patjetër të ketë për bazë besimin mes Serbëve dhe Shqiptarëve.*

Në një dokument tjetër serb, të datës 25 korrik 1912, sekretari i Ministrsisë së Punëve të jashtme të Serbisë, Vlladeta Kovaçeviq<sup>2</sup>, personalisht kishte udhëtuar për në Shkup, prej aty me tren drejt Prishtinës për tu takuar me Bajram Currin dhe Hasan Prishtinën, në kuadër të politikës së theksuar më lartë, për të përfituar besimin e shqiptarëve në çfardo mënyre, kësaj radhe me para dhe armatim, kundër Perëndorisë Osmane. Dmth pikat e letrës së lartpërmendur vetëm se kishin filluar të implementoheshin edhe prej më parë, por këtu ky informon shefin e tij për akcionin e tij në Shkup. Ajo letër iu ishte dërguar gjitha konsulatave serbe në teritoret e Perëndorisë Osmane të banuar me shqiptarë. Ai në misionin e tij, ku shihet qartë nga letra-raporti i tij, jo vetëm që mundohej të përfitonte prijësit shqiptarë dhe mundohej të fuste përçarje mes tyre, por edhe vëzhgonte situatën e tensionuar në Prishtinë, Kaçanik e Ferizaj dhe me pyetje të ndryshme mundohej të nxirte qëndrimet e prijësve shqiptarë. Ai ishte nisur për tu takuar me Hasan Prishtinën e Bajram Currin dhe Isa Boletinin, por për shkak të rrethanave ai u takua vetëm me Riza Beun të dërguarin e Bajram Currit të cilit i dha para dhe i premtoi 400 pushkë e 10 revolvera. Ai pyeti tërthorazi Riza Beun se ju si Kryengritës po të depërtonit deri në Shkup e ta merrnit nga turqit, çka do bënit? Do ndaheshit nga Turqia? Riza Beu ju përgjigj, se jo nuk do ndaheshin nga Turqia por do kërkonin të drejtat e Hyrijetit dhe vendi të qeverisej nga tanët, që don të thotë një lloj autonomie të Shqiptarëve, ndërsa të gjithë popujt tjerë do kishin të drejta të barabarta. Pasi nuk u takua me prijësit tjerë ai u kthye në Shkup e prej aty në Beograd, ku e bëri këtë raport.

Në vitin 1924, Sherbimi sekret serb harton një Udhëzim për punën dhe aktivitetin e xhandarmerisë serbe për shkatërrimin e çetave “Kaçake” në trojet etnike shqiptare nën pushtetin serb (atë kohë Mbretëria SKS).

Ky Udhëzim përmban 17 faqe dhe në imtësira analizohet situata në trojet shqiptare në Mbretërinë SKS, duke dhënë edhe detyra konkrete për secilën pjesë të pushtetit posaçërisht policinë dhe forcat ushtarake sipas të cilave ata duheshin vepruar në terrenin konkret.

Në fillim në katër pika përmbledhet si hyrje analizë të fenomeneve shqiptare, gjajkmarrja, mospërkulja ndaj pushtetit serb, kundërshtimi i sherbimit ushtarak dhe rrebelimi i shqiptarëve. Pastaj analizohet Lëvizja dhe organizimi i shqiptarëve dhe çdo organizim të shqiptarëve ata e

<sup>2</sup> ASHRMV, MF.477; Letër e Vlladeta Kovaçeviq, Ministrin të jashtëm Jovan jovanoviq! Beograd, 25.07.1912.

quajnë me termin vullgar “Kaçak” duke përcjellur në imtësira e në baza ditore aktivitetin e LKSH dhe Komitetit të Kosovës në teren, por edhe në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pjesa më e madhe e dokumentit përqëndrohet te puna e organeve serbe për asgjësimin dhe paralizimin e LKSH dhe Komitetit të Kosovës duke hyre në detale për mënyrën dhe aktivitetin e çdo zyrtari, deri tek polici më i thjeshtë apo ushtari si dhe popullatës koloniste serbe e malazeze. Aty referohen, shenjat, sinjalet, puna ne teren, sherbimi i spiunimit, kurthet, sjellja e policise dhe ushtareve, bastisjet, rekrutimi i agjenteve shqiptare dhe në fund përfitimi i popullatës shqiptare për interesat shtetërore serbe<sup>3</sup>.....

Pjesë jo më pak e rëndësishme për Serbinë ishte edhe dëbimi i shqiptarëve nga trojet e tyre etnike dhe kolonizimi i tyre me element serb. Dëbimi i shqiptarëve është bërë gjat dhe menjëherë pas luftave duke filluar nga viti 1876/78 kur teroret e pushtuara të Perëndorisë Osmane nga Vranja deri në Prokuplje e më tej u zbrazën me dhunë nga shqiptarët. Dëbimi dhe terrori masiv ndaj shqiptarëve ndodhi edhe gjat dhe pas Luftave ballkanike 1912-1913, ku një pjesë e madhe e shqiptarëve të Kosovës, Luginës së Preshevës dhe Maqedonisë së sotme u masakruan dhe u dëbuan nga trojet e tyre. Një pjesë e madhe e tyre në Turqi ndërsa një pjesë edhe në Shqipërinë. Duke filluar nga vitet 1920 Serbia filloi kolonizimin masiv të ktyre trojeve dhe paralel vazhdoi agjendën e saj për të inkurajuar me metoda të ndryshme shpërnguljen e shqiptarëve në të shumtën e rasteve drejt Turqisë. Kjo ndodhte gjat gjithë periudhës mes dy Luftave Botërore 1919-1941, posaçërisht u intensifikua pas viteve 1930.

Në një regjistër të pasaportave të lëshuara në Komunën e Shkupit për vitet 1927,1928 dhe 1929<sup>4</sup> kjo pasqyrohet shumë qartë. Nga 1767 dosje të pasaportave të lëshuara 551 prej tyre e kanë evidentuar se udhëtojnë drejt Turqisë, ku 183 nga këto dosje, numri i tyre është rrethuar me të kuqe, që don të thotë janë fshi nga shtetësia serbe ndërsa edhe pjesa tjetër në të shumtën e rasteve kanë emigruar përgjithmonë në Turqi. Këto dosje (pasaporta) ishin të shoqëruara me fotografi, dhe në këtë rast gati të gjitha janë pasaporta familjare që shkonin deri në 16 antarë të një familje që emigronte në Turqi. Nëse i marrim dhe i mbledhim vetëm këto 183 dosje sipas familjeve ku numri shkon nga 2 deri 16, dhe marrim një mesatare 6 antarë, vijmë te përfundimi se vetëm në tre vjet, nga Shkupi në Turqi janë shpërngulur përgjithmonë mbi 1000 banorë musliman (në shumicë të madhe shqiptarë). Po nëse te ky numër shtojmë po me këtë mesatare apo edhe me një mesatare më të vogël të 368 dosjeve tjera ku gjithjashtu janë shqiptarë por jo të rrethuar me të kuqe, edhe aty del numri mbi 1000 që na sjell tek përfundimi logjik dhe i dokumentuar edhe me këto dosje, me emra, mbiemra dhe foto se nga Shkupi, për këto tre vjet janë shpërngulur përgjithmonë mbi 2000 shqiptarë për në Turqi.

Interesante është se në këtë regjistër kemi edhe disa raste të emigrimit të shqiptarëve nga Shkupi për në Shqipëri, por këtu numri është dukshëm më i vogël, arrin deri në 10 familje.

Politika e tillë e shtypjes ndaj shqiptarëve vazhdoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore, në Jugosllavinë komuniste të Titos, të formuar më 1944 dhe zgjati me më shumë apo më pak intensitet deri në vitet e 90 të shekullit XX, por kjo do jetë temë e studimeve tjera.

---

<sup>3</sup> M.Bislimi, Raporte sekrete të Mbretërisë SKS-Jugosllave, për Komitetin e Kosovës (1924-1941), ASHRMV, Shkup, 2017,11-42. (Dokument shum[ sekret i Sh[rbimit informativ Ushtarak t[ Mbret[ris] SKS i shfryt[zuar nga arkivi i Institutit të Historisë nacionale-Shkup, KXXXVI/8, Nr.805, Uput za rad @andarmerije u ciqu uni{tavava Ka~a~kih bandi u Ju`noj Srbiji; Str. Pov. Br.2889, 2 novembar 1924, Beograd,17 str.)

<sup>4</sup> M. Bislimi, Dokumente serbe per historine e Maqedonise, Kryesia e qytetit te Shkupit, Libri i Pasaportave 1927-1929, ASHRMV, Shkup, 2021, 560.